

BARDHYL DEMIRAJ — ANILA OMARI

MARTIN E. HULD, «**BASIC ALBANIAN ETYMOLOGIES**»

California State University, Los Angelos Slavica
Publishers, Inc. 1984, X + 213 f.

Në vijim të hulumtimeve të tij diakronike në fushë të shqipes¹, studiuesi i ri amerikan Martin E. Huld botoi kohët e fundit monografinë e tij të parë «Etimilogjitet bazë të shqipes». Vepra i kushtohet njërisë prej temave më të vështira në historinë e kësaj gjuhe. Aty citohen vetëm gjuhëtarë të tillë të shquar si G. Majeri, H. Pedersen, M. Fasmeri (M. Vasmer), N. Jokli, E. Çabej, E. Hempi e ndonjë tjeter.

Me këtë punim autor i synon t'u bëjë të njojur gjuhëtarëve indoевropianistë një bazë, nga e cila mund të deduktohen tiparet historike të gjuhës shqipe. E këtë qëllim ai mendon se e përbush plotësisht hulumtimi etimologjik i njësive leksikore të trashëguara, të vëzhguara këto kryesisht nga këndvështrimi i indo-evropianistik. Megjithatë, në vepër, Huldi nuk do të kufizohet vetëm në këtë plan të studimit. I joshur nga rezultatet e analizave etimologjike, ai rraket të shuestojë një vizion të përgjithshëm mbi zhvillimin e sistemit fonetik të shqipes si edhe mbi vendin që zë kjo gjuhë në qerthullin e gjuhëve indoevropiane.

Punimit i paraprin një triptik hyrës (I, *Sfondi historik dhe etnografik*, f.1-14; II. *Plani i fjalorthit*, f.15-20, III. *Inventari fonemik i dialekteve të shqyrtuara*, f.20-36), mëse i nevojshëm për një rreth të gjérë specialistësh indoevropianistë që nuk e njojin nga afër gjuhën shqipe dhe historinë e saj në përgjithësi. Jepen gjithash tu edhe shpjegime plotësuese për materialin gjuhësor që shtjellohet si edhe për qëndrimin teorik dhe metodën e analizës gjuhësore që zbaton vetë autor i ne punim.

Vendin kryesor në vepër e zë fjalorthi etimologjik (f.37-138) prej 250 njësish, shumica e të cilave pranohen tashmë si pjesë e trashëgimisë i.e. (=indoevropiane) të gjuhës shqipe. Për çdo njësi Huldi bën në fillim një përqasje të varianteve dialektore, ku vëmendje e veçantë u kushtohet të dhënave nga të folmet konservatore, duke përfshirë këtu edhe diasporën shqiptare të Greqisë dhe të Italisë. Kjo përqasje i shërben më tej si pikënisje për rindërtimet etimologjike të trajtës përfaqësuese të fjalës në dy nivelet e së ashtuquajturës protoshqipe². Niveli i dytë, i shënuar me simbolin 1, mendohet nga autor i një rindërtim si-përfaqësor, që ndryshon pak nga shumica e të folmeve konservatore toske, d.m.th. si faza që i paraprin ndarjes dialektore të shqipes. Midis këtij niveli dhe fazës i.e. të gjuhës,-periudha kur shqipja nuk qe shkëputur ende nga trungu i përbashkët i.e. —, Huldi vendon nivelin e parë, të shënuar me simbolin 1. Ky nivel, më fort se një shtresim i gjithëmbarshëm kronologjik, qoftë ky absolut apo relativ, është një kriter metodik që e ndihmon autorin gjatë hulumtimeve etimologjike, me

1) Shih, ndër të tjera, *Albanian yll «star»*, KZ 90, 1976, f. 176-182; *Albanian i thellë and its eastern relations*, KZ, 92, 1978, f. 297-99; *Albanian ju*, JIES 7, 1979, f. 303-6; *Birds, beasts and Indo-European merismatic compounds in Albanian*, KZ 96, 1981, f. 302-8.

2) Do shënuar këtu se në vepër Huldi nuk jep një shpjegim të qartë të këtij termini. Pas gjithë gjasash, me *protoshqipe* ai nënkupton të gjithë fazën e zhvillimit të gjuhës shqipe që nga shkëputja e saj prej trungut të përbashkë indo-evropian deri në kohën e dyzimit dialektor.

qëllim që të ftillojë radhën e bashkëveprimit të dukurive të ndryshme brenda strukturës fonologjike të secilës njësi leksikore më vete (khs. p.sh. *barrē* < protoshq. *仗/bara/* < **barCo/* < P.IE. **bhor-no-m*). Në ato raste kur ky bashkëveprim mungon, atëherë edhe autorri nuk e paraqet nivelin e parë të supozuar (khs. *motēr* < protoshq. *母/motra/* < P.IE. **meAter/*). Rindërtimet për të dy nivelet bëhen pasi autorri përcjell me stil të thukët literaturën etimologjike të mëparshme qysh nga G.Majeri.

Në punim nuk mungojnë syzimet e hapëta për trajtën përfaqësuese të çdo fjale në plan i.e. Në këtë kuadër autorri merr në analizë rindërtimet etimologjike kryesore të mëparshme, duke u përqendruar më shumë në aspektin fonetik, menjithëse nuk e lë pas dore as aspektin gramatikor-fjalëformues dhe semantik. Pas çdo vëzhgimi ai krahason përfundimet e veta me ato të fjalorit etimologjik të J.Pokornit³. Nëpërmjet këtyre përqasjeve lexuesi njihet, ndër të tjera, edhe me zhvillimet e reja që po përjeton gjuhësia indoevropiane në këta dy dhjetë vjeçarët e fundit, sidomos në fushën e fonologjisë segmentale, të tilla janë, p.sh., sistemi me tri seri i mylltoreve i.e., ku mungon seria e të pazëshmeve të aspiruara, sistemi me tri gjymtyrë i fonemave zanore */a/, /e/, /o/*, ku të mëparshmet */i/, /u/* bashkohen me grupin e sonanteve */r/, /l/, /m/, /n/* me tiparin [\pm rrrokjeimbartës] etj. Madje në ndonjë rast, Huldi ndjek një hulli të vetën. I tillë është p.sh. qëndrimi që mban ai ndaj numrit të fonemave laringale të supozuara për gjuhën bazë. Ndryshe nga drejtimet e sotme laringaliste amerikane dhe evropiane që rindërtojnë për gjuhën bazë i.e. përkatësisht katër dhe tri laringale, Huldi e rrit numrin e tyre në gjashtë ($E_1, E_2, A_1, A_2, O_1, O_2$), duke i grupuar në tri çifte, të dalluara me tiparin [\pm i zëshëm].

Për studimet diakronike të kësaj natyre, siç janë fjalorët etimologjikë, është vështirë që brenda një recensioni të bëhen vlerësimë të hollësishme për të gjitha rezultatet e arritura nga vëzhgimi shumëplanësh i njësive leksikore të marra në shqyrtim. Prandaj këtu do të kufizohemi vetëm në disa konsiderata të përgjithshme.

Punimi paraqitet si një përpjekje e re sintetizuese, ku pasqyrohen në mënyrë kritike rezultatet më të arritura si edhe problemet e ngritura në këtë ndërkokë nga studiues të ndryshëm në fushë të shqipes. Në shumicën e analizave dia-kronike, Huldi pajtohet me një nga interpretimet etimologjike të mëparshme, por nuk mungojnë rastet, kur ai bën plotësimë të pjesshme të tyre herë në planin fonologjik e herë në atë gramatikor e semantik. Përmendim këtu syzimet e imprehta për njësi të tilla si *ju* me një variant të bazës së rindërtuar **/ges/* në shkallën e apofonike zero, *sy* me një nga format e bazës **/ok^v/*, *pjell* < **/pel-oA₁/*, *shi* me një nga variantet e bazës **/seu/* në shkallën apofonike zero; *mbesë* < **/nepöt-i-eA₂/*, *motēr* < **/meAter/*, *muaj* < **/meEns-/*; *ndjek* < **/Eentek -oA₁/*, *njeri* < **/A₁ner-/*; *njoh* < **/g'noO₁ - ēskoA₁/*, *pesë* < */penk^ve/*, *shtyj* < */stud-nj-oA₁/*, *thaj* < **/saus-ni-oA₁/* etj.

Në këto vëzhgime autorri sheston rrugën evolutive të strukturave fonologjike përkatëse qysh nga faza i.e. e gjuhës. E këtë ai e arrin duke bashkëlidhur organizht rindërtimin e brendshëm gjuhësor me krahasimin e jashtëm me gjuhët e tjera i.e. si dhe me të ashtuquajturin rindërtim nga sipër, ku merren si pikënisje rezultatet më të sigurta në gjuhësinë indoevropiane.

Në punim nuk mungojnë gjithashtu përpjekjet origjinale të Huldit për të filluar etimonet e shumë njësive leksikore, të cilat, për vetë shkallën e vështirë-

3) Shih J. Pokorny, *Indogermanisches Etymologisches Wörterbuch*, I, Bern: u. München, 1959.

sisë që i karakterizon, vazhdojnë të qëndrojnë pezull në studimet albanologjike të derisotme. Përmirësimet për këto njësi janë, sipas rastit, herë gjithëplanëshe, herë përqendrohen në njërin plan të studimit. Gjithsesi autori është i vetëdijshëm se për një numër syresh rezultatet s'janë përfundimtare. Kështu humbtime me interes bëhen për njësi të tilla, si: *vjeħerr.*, të cilën autori e shpjegon me një formë të rindërtuar me metatezë *-/għesk'uros/ nga baza i.e. */suekuros/; *i thelle* nga baza */k'ouO₂lo-/ si një nga dëshmitë e pakta që vërtetojnë bjerrjen pa lënë **gjurmë** të një laringali në pozicion ndërrokjesor: *zet* < * /uik'mt-oi/ dhe *zot* < */uik'(eA₂) + potis/, tek të cilat Huldi mbështet një mendim të Hempi për zhvillimin e supozuar */uik'->shq./z/; *mal* < */mlO₂dh-o/; *gur* < */gvr-/; *djathie* < * / dhedhE/; *emēr* < */E₁nmen/ etj.


Por ka edhe asosh që për një arsy a për një tjetër nuk mund t'i qëndrojnë dot kritikës. Kështu, p.sh., në shpjegimin etimologjik të njësisë *yll*, Huldi ri ndërtón një formë pa /s/- nistore */Eus-li/ dhe vokalizmin /y/ të rrënjes e shpjegon me një zhvillim metafonik /u/ → /y/ të shkaktuar nga forma e rrokjes ndjekëse /i/. Ky shpjegim s'mund të qëndrojë për vetë faktin se fonema /i/ krahas metafonisë do të shkaktonte edhe palatalizimin e lëngëtores paraprijëse. Interpretime të mangëta vërehen edhe për njësi të ndryshme, si *gjuhë* < */g'hund-sk'eA₂/; *i madh* < */mag'E₂-io-/; *mjekér* < */smek'-er-/; *një* < */sm-i(e)A₂/; *shtazë* < */kv^otor-pd-ieA₂/; *dhjetë* < */dek'mti/grua < */greA₁u-/ etj. Në punim ka dhe një

numër vëzhgimesh që janë hipotetike edhe për vetë autorin. Format e rindërtuara për këto njësi, Huldi i paraprin me një pikëpyetje. Ndërsa për disa të tjera ai ngurron të bëjë rindërtim të tilla.

Sic e yumë në dukje edhe më lart, krahas zhvillimit të mirëfilltë etimologjik të njësive leksikore të përzgħedhura e të lidhura ngushtë me tē, në veprer janë trajtuar edhe dy probleme të tjera, të cilat dalin në formën e studimeve.-shto jca: «Tabela e zhvillimeve kryesore të tingujve i.e. në shqipe» (f.138-157) dhe «Marré dhëni e shqipes me gjuhët e tyre i.e. » (f.158-70). Edhe këto studime paraqiten më fort si përpjekje sintetizuese të mendimit gjuhësor të derisotém në fushën e albanologjisë, ku, pa dyshim, në shumë raste, parashtron edhe vëzhgimet vetjake të autorit.

Në zhvillimin e sistemit të fonemave i.e. në gjuhën shqipe, — kryesisht për zanoret dhe mbylltoret, — Huldi rreket të paraqesë statusin e tyre fonemik në tri fazë evolutive: I. protoindoevropianishtja; II. protoshqipja; III. shqipja e sotme. Kështu p.sh., në zhvillimin e fonemave zanore i.e. në shqipe Huldi na jep këtë pasqyrë zhvillimi: (shih pasqyrën në f. 206)

Ndër problemet që kanë mbetur ende të pagzjiddura në këtë fushë studimi, Huldi merret më nga afér me zhvillimin e spirantes i.e. */s/ dhe me reflekset e palataleve */k'/, */g'/, */g'h/ në shqipe. Lidhur me fatin e spirantes i.e. */s/né shqipe ai i pranon të gjitha reflekset e supozuara më parë /ʃ/, /ǵ/, /θ/, /h/ veçse kufizon veprimin e refleksit të fundit (* /s/ → /h/). Sikurse më parë E. Hempi, edhe ai e vë në dyshim këtë refleks në rastet kur /s/ ndodhet në pozicion nistor. Pavarësisht nga fakti që shpjegimi etimologjik i shembuje të sjellë për krahasim ka mangësi, autori duhej ta kish shtrirë këtë supozim edhe për pozicionet e tjera të mundshme të fonemës në fjalë. Lidhur me zhvillimin e palataleve i.e. në shqipe, autori tumir mendimin se ato janë reflektuar në shqipe edhe me spirantet /s/, /z/, krahas zhvillineve të tjera: /θ/, /ð/ e /k/, /g/. Pavarësisht nga saktësia e këtij



vëzhgimi, Huldi ka meritën që e kufizon veprimin e këtij refleksi vetëm në pozicion para zanoreve /u/ dhe gjysmëzanoreve /i/, /u/. Ndër fonemat mbisegmentale, Huldi shqyrton edhe vendin e gjatësisë së zanoreve, duke mbrojtur me argumente të reja tezën që në shqipen e sotme nuk ndeshen gjurmë të gjatësisë burimore i.e.

Duhet të shtojmë gjithashtu që një numër problemesh të errëta në fonologjinë historike të shqipes, si p.sh. zhvillimet e sonanteve rrokjeformuese, të laringaleve, të gjysmëzanoreve etj. Huldi druhet t'i shqyrtojë ballas. Kjo është e kushtëuar dhe nga vështirësitë e karakterit objektiv dhe subjektiv që vazhdojnë ende të mbizotërojnë në humumtimin diakronik të gjuhëve të tillë si shqipja.

Në shtojcën e dytë të punimit Huldi shqyrton në mënyrë të përbledhur disa probleme të tjera kyçë në historinë e gjuhës shqipe, siç janë vendi i shqipes në rrëthin e gjuhëve i.e., origjina e shqipes, kufijtë hapësinorë dhe kohorë të saj në fazat e ndryshme të parahistorisë dhe të historisë së Evropës etj. Pa synuar një zgjidhje shteruese të këtyre çështjeve, Huldi jep në mënyrë të përbledhur arritjet kryesore të derisotme në albanologji e për ndonjë syresh nuk mungon të bëjë edhe ndonjë vërejtje plotësuese.

Të tillë janë p.sh. vëzhgimet e autorit mbi vendin e shqipes brenda grupit të gjuhëve satem. Huldi plotëson me fakte të reja tezën që shqipja zë një pozicion të veçantë brenda këtij grupei. E këtë s'e dëshmon vetëm zhvillimi i shmangur i labiovelareve i.e. (*/kʰv/, */gʰv/, */gʰh/), që jo në çdo rast përpunhet me atë të vela-eve të thjeshta (/k/ /g/ /gh/), por edhe çqiqellzorizimi i rregullt i palataleve i.e.

*) Shenjuesi i gjatësisë jepet me dyfishimin e zanoreve

(/k'/, /g'/, /g'h/) në pozicion para sonanteve jorrokjembartëse (/r/, /l/, /m/, /n/). Meritë e veçantë e autorit është vëzhgimi që shqipja, ndryshe nga shumica dërrmuese e gjuhëve të grupit satem, nuk i nënshtrohet të ashtuquajturit *RUKI-Regel* (reflekset e spirantes /s/ pas /r/, /u/, /k/, /i/). Përfundimet e arritura gjatë këtyre analizave diakronike në fushë të shqipes tumirin plotësisht mendimin që po ze vend gjithnjë e më shumë në indoевropianistikë, i cili vë në diskutim ndarjen e gjuhëve i.e. në kentum dhe satem.

Për sa i takon vendit të shqipes në rrëthin e gjuhëve i.e. Huldi afrohet në përgjithësi me qëndrimin e A.Meillet, duke e lokalizuar shqipen në qendër të periferisë, si një idiomë kalimtare ndërmjet grupit veriperëndimor, ku lidhjet më të qëndrueshme janë me sllavishten dhe baltishten, dhe një grapi juglindor të pafiksuar mirë, ku vend qendorr zënë greqishtja dhe armenishtja, e më tej edhe hetitishtja e tokarishtja. Ky vëzhgim i Huldit nuk bie ndesh, por provon më tej me mjete gjuhësore, përcaktimin e Nopcsa (Nopcsa) ndaj kulturës shqiptare si vijim i kulturës së Hallshtatit (Hallstadt). Ndërsa në planin gjuhësor ai paraqitet si një variant i tezës së mbrojtur nga E.Hempi në një numër artikuash të kohëve të fundit, sipas së cilës shqipja është pinjoll i vetëm i një familjeje *albanoidë* të dikurshme që shtrihet nga Ukraina deri në perëndim të Ballkanit.

Për Huldin, termi *gjuhë albanoidë* është më tepër një konvencion, i kushtëzuar nga fakti që problemi shqyrtohet nga këndvështrimi i indoevropianistit dhe përkëtë qëllim u drejtohet kryesisht periudhave tepër të hershme të parahistorisë së gjuhëve (periudha e hekurit). Lidhur me periudhat e mëvonshme parahistorike dhe historike, Huldi bashkohet pa ngurrim me grupin e atyre gjuhëtarëve që mbështesin vendin e formimit të shqipes dhe të popullit shqiptar në trevat e sotme, qysh në periudhën e ndikimit latin, shumë kohë para ardhjes së sllavëve në Ballkan.

Duke përfunduar këtë paraqitje të përbledhur të përbajtjes dhe të vlerave të veprës, pohojmë se kemi të bëjmë me një ndihmesë në fushën e studimeve historike të gjuhës shqipe. Në të rrihen çështje të rëndësishme, në të cilat autori jo vetëm mbështet mendimet objektive e tashmë të argumentuara, por në disa raste sjell edhe interpretime të reja me vlerë.